



CIVIL
SOCIETY
FORUM | TIRANA
2023



KONVERGJENCA E ARDHMËRIVE: INTEGRIMI EKONOMIK I BALLKANIT PERËNDIMOR NË BASHKIMIN EVROPIAN



KONVERGJENCA E ARDHMËRIVE: INTEGRIMI EKONOMIK I BALLKANIT PERËNDIMOR NË BASHKIMIN EVROPIAN

Autorë:

Stefan Ristovski dhe Simonida Kacarska

Kontribuesit:

Silvana Mojsovska, Matteo Bonomi dhe Zlatko Veterovski

Rishikuesi:

Isabelle Ioannides

Ky dokument është i bazuar mbi inputet nga tre onlajn ngjarjet rajonale për konsultim dhe një ngjarje publike hibride të Grupit tematik punues “Qasja në Tregun e Vetëm Evropian” të organizuara në periudhën ndërmjet muajit qershor dhe shtator të vitit 2023. Grupi tematik punues, i udhëhequr nga Instituti për Politika Evropiane në Shkup, ka mbledhur më tepër se 40 ekspertë të shoqërisë civile, akademisë, sektorit privat dhe administratës shtetërore nga gjashtësi i Ballkanit Perëndimor dhe Vendet Anëtare.¹

¹ Instituti për Politikë Evropiane në Shkup shpreh mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit në grupin tematik punues. Mirënjohje e veçantë u dedikohet Silvana Mojsovska, Mateo Bonomi dhe Zlatko Veterovski për inputin e tyre të çmuar për sesionet tematike.

Dhjetë vite me radhë, Procesi i Berlinit ka mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të Ballkanit Perëndimor duke u përkujdesur për projektin e lidhshmërisë në rajon, ndërkaq duke i avancuar mundësitë e integritimeve evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor.² Institucionet e BE-së dhe vendet anëtare janë zotuar për mbështetje teknike dhe financiare që ofrojnë stimul për bashkëpunim në fushat strategjike industriale dhe për t'i përkrahur tregjet rajonale për të qenë më konkurrentë.³

Gjatë viteve të fundit, modalitetet e politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE) janë diskutuar gjerësisht nëpër Evropë. Komuniteti think-tenk ka propozuar integrim gradual, në faza dhe me sektorë ose pjesëmarrje të plotë në Tregun e Vetëm të BE-së. Këto propozime kanë për synim të mbushin boshllëkun e krijuar nga progresi i ngadalshëm në përmbushjen e tiparit "phase-in" të metodologjisë së zgjerimit dhe të procesit të zgjerimit në tërësi. Në pajtim me propozimet e shoqërisë civile, kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen e prezantoi planin prej katër shtyllash për Ballkanin Perëndimor: asocijim më të afërt me Tregun e Vetëm, thellim i integritimit ekonomik të rajonit, përshejtim i reformave fundamentale dhe zmadhim i fondëve paraaderuese.

Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës krijoi momentum të ri gjeopolitik për procesin e zgjerimit. Përgjigjja e BE-së ka treguar që kufizimet e shpejta tregtare, nismat për integrimin e tregut dhe financimet e zmadhuara janë të mundshme në ndryshimin e kontekstit gjeopolitik. Gjithashtu ekziston një nevojë urgjente për përgjigje të shpejtë për Ballkanin Perëndimor, gjatë kësaj duke e theksuar **sundimin e së drejtës si parim kryesor**.

Duke i pasur parasysh zhvillimet politike në Evropë, samiti i ardhshëm i Procesit të Berlinit duhet të ofrojë propozime dhe nisma konkrete për përforcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe integritimit ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së para aderimit. Përfshirja aktive nga ana e BE-së dhe e vendeve anëtare, veçanërisht e atyre që marrin pjesë në Procesin e Berlinit është e nevojshme për të mbështetur rajonin dhe **qartë për të ofruar integrim të mëtejshëm** në Tregun e Vetëm, të ndihmojë për fuqizimin kornizës për qeverisje ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe rritjen e fondeve të BE-së për të përkrahur konvergencën ekonomike. Paralelisht me këtë, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërmarrin dhe t'i zbatojnë reformat e nevojshme për t'i përmbushur rregullat dhe standardet e BE-së për produkte dhe shërbime si dhe për pjesë tjera relevante të 'acquis'-ë së Tregut të Vetëm, të fuqizojnë menaxhimin me financat publike dhe t'i përshejtojnë reformat strukturale.

2 Final Declaration by the Chair of the Conference on the Western Balkans, 2014

3 Common Regional Market - A catalyst for deeper regional economic integration and a stepping stone towards EU Single Market

Të ofrohet aderim i avancuar në Tregun e Vetëm të BE-së si pjesë e procesit të aderimit

Integrimi më i thellë me BE-në mund të gjenerojë përkrahje të integritit të zinxhirit të vlerës dhe pritjet që ta zmadhojë edhe eksportin e materialeve për prodhim ushqimor edhe të produkteve përfundimtare ushqimore në Tregun e Vetëm të BE-së.⁴ Me mënjanimin e tarifave dhe liberalizimin tregtar nga fillimi i viteve 2000 dhe me vendosjen e zonës së lirë tregtare sipas MSA, BE është bërë partneri kryesor tregtar i vendeve të Ballkanit Perëndimor, me të cilin realizohet dy e treta e tregtisë së rajonit. Sido që të jetë, pjesëmarrja e rajonit në tregtinë e përgjithshme të BE-së është margjinale.⁵ Pavarësisht preferencave dhe potencialeve tregtare ndërmjet BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6), raportet tregtare u nënshtrohen barrierave jotarifore tregtare (NBT-të). Dallimet në rregulloret teknike, me të cilat kërkohen licenca dhe certifikata dhe dokumente tjera përputhshmërie të produkteve i zmadhojnë shpenzimet dhe çrregullojnë tregtinë ndërmjet palëve. Së këtejmi, integrimi i mëtejshëm, para aderimit të plotë mund të jetë një mënyrë premtuese në drejtim të përmirësimit të standardeve të jetës në BP6,⁶ me kosto të ulët ekonomike e politike për BE-në. Disa sfida duhet të merren parasysh kur diskutohet lidhur me ndarjen e granteve aderuese në Tregun e Vetëm të BE-së për BP6.

Së pari, Tregu i Vetëm i BE-së është i themeluar mbi respektimin e sundimit të së drejtës. Duhet të themelohen trupa të mëdhenj dhe të paanshëm rregullatorë dhe ato kanë rëndësi thelbësore për mbikëqyrjen e zbatimit të 'acquis'-së së BE-së. Pjesëmarrësit e tregut drejtohen te sistemet e pavarura gjyqësore për të kërkuar drejtësi për zbatimin e drejtë dhe të barabartë të rregullave të BE-së. Bashkëpunimi gjyqësor dhe njohja e vendimeve gjyqësore në çështje civile dhe tregtare kryesisht varen nga gjykatat nacionale. Prandaj, pavarësia gjyqësore, ose mungesa e saj, mbetet të jetë fusha më e dobët për rajonin. Nga kjo perspektivë, fuqizimi i sundimit të së drejtës në BP6 bëhet parakusht thelbësor për suksesin e çfarëdo politike të propozuar, duke përfshirë qasje të lehtësuara në Tregun e Vetëm.

Së dyti, në kuptim të harmonizimit me dhe implementimit të 'acquis'-së së BE-së në rajon, tempa dallon nga vendi në vend, për secilën nga katër liritë. Nga ana tjetër, nevoja për përforcimin e kapaciteteve të institucioneve kryesore që mund të monitorojnë zbatimin e rregullave dhe standardeve relevante është me rëndësi në çdo aspekt. Zhvillimet e vazhdueshme politike, siç janë reformat në unionin e doganave dhe mekanizmi për përcaktimin e kufijve të karbonit, duke përfshirë edhe strukturat e reja të tregtisë, veçanërisht rritja e mallrave tregtare dhe të paketuara do të ndikojnë me rritje të shpenzimeve për përputhshmëri jo vetëm për institucionet shtetërore por edhe për sektorin privat që bartin detyrimet për harmonizim me rregullat dhe standardet e BE-së. Gjithashtu është e nevojshme që gjatë shqyrtimeve për liberalizimin e tregut, të kushtohet vëmendje përkatëse për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave. Emigrimi dhe eksporti i kapitalit janë ose më së paku konsiderohet se shkaktojnë efekte shkatërruese mbi ekonominë e vendeve.

4 Oliver Reiter dhe Robert Stehrer, Value Chain Integration of the Western Balkan Countries and Policy Options for the Post-COVID-19 Period, Instituti i Vienës për Çështje Ekonomike, mars 2021

5 https://policy.trade.ec.europa.eu/eu-trade-relationships-country-and-region/countries-and-regions/western-balkans_en

6 Richard Grieveson, A change of EU strategy in the Western Balkans is long overdue, Instituti i Vienës për Studime Ekonomike, shtator 2020

Së treti, logjika e organizimit institucional hap një debat të gjerë lidhur me mënyrën e qasjes ndaj integritimit në tregun e BE-së për BP6. MSA-të ofrojnë bazë solide ligjore për produktet që vijnë nga Ballkani Perëndimor për të pranuar trajtim të brendshëm tregtar, të kushtëzuar me harmonizimin me 'acquis'-në përkatëse.⁷ Komuniteti energjetik dhe komuniteti i transportit, si dhe fusha e Aviacionit Civil Evropian, shërbejnë për integrimin sektorial të BP6 në Tregun e Vetëm të BE-së në fushat konkrete për mallra dhe shërbime. Megjithatë, ekziston rreziku që shumë modalitete të ndryshme të implementimit dhe monitorimit të tiparit "phasing-in", paralelisht me MSA-të dhe marrëveshjet shumëpalëshe sektoriale, mund ta bëjnë procesin edhe më të ndërlikuar dhe më pak të kuptueshëm për bizneset dhe qytetarët e rajonit.

Së katërti, vendet e Ballkanit Perëndimor i janë përkushtuar një plani aksional për të krijuar Treg të Përbashkët Rajonal (TPR) në investimet tregtare, fushat digjitale, industriale dhe të inovimeve. Ky plan është perceptuar si një platformë kalimi për në Tregun e Vetëm të BE-së. Nën ndikimin e kontesteve bilaterale dhe pengesave politike, miratimi dhe implementimi i dinamikave të aksioneve të synuara për TPR, veçanërisht në fushën e tregtisë, përkatësisht katër liritë, rrjedhin me temp të ngadalshëm deri në atë shkallë sa që dekurajon. Megjithëse në këtë proces investohet kapital i konsiderueshëm politik nga ana e institucioneve dhe vendeve anëtare të BE-së, TPR nuk e realizon potencialin e vet. Nga ana tjetër, qasja në Tregun e Vetëm të BE-së është ofertë më atraktive për vendet e rajonit. Vendet e Vishegradit shërbejnë si shembull që integrimi më i thellë në BE, vetvetiu mund të stimulojë lidhje me të thella rajonale.⁸ Madhësia e tregut dhe raportet tanimë të vendosura tregtare ofrojnë më tepër mundësi biznesi. Nëse lidhen së bashku, këto procese mund të fuqizohen ndërmjet vete: qasja në Tregun e Vetëm të BE-së mund të jetë stimul për realizimin e TPR-së.

Në këtë kontekst, **Komisioni Evropian duhet të prezantojë një plan me kornizë të realizueshme kohore për t'ua lejuar tregjeve të BP6 shpejtë t'i qasen Tregut të Vetëm të BE-së në të gjitha sferat që nuk do të imponojnë shpenzime të larta të përshtatjes dhe do të ishin shumë të dobishme dhe të dukshme për bizneset dhe qytetarët me aderimin në BE si objektivi përfundimtar.** Duhet të anashkalohet fragmentimi i mëtejshëm. Qasja në Tregun e Vetëm duhet të kombinohet me proceset aktuale rrjedhëse në vendet e Ballkanit Perëndimor, siç janë negociatat për aderim dhe skringu si dhe realizimi i TPR-së. Komisioni duhet të aplikojë kushtëzim rigoroz mbi sundimin e së drejtës dhe funksionimin e institucioneve për çështjet kryesore të cilat duhet t'i përm-bushin qeveritë e BP6.

Çiftimi i institucioneve në vendet e BP6 dhe homologët e tyre në vendet anëtare të BE-së, duke i përfshirë ato që janë pjesë e Procesit të Berlinit, nëpërmjet projekteve tuining dhe përkrahjes teknike mund të jenë një përvojë thelbësore nga e cila mund të mësohet. Një qasje e tillë mund të ofrojë përvojë mësimi dhe për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe për socializim dhe bashkërenditje të politikave ndërmjet institucioneve nacionale ndërkaj duke e mbajtur procesin e integritimit në BE në zemrën e procesit.

7 Për një analizë më të detajuar, shihni Zoran Sretić, Sectoral integration opportunities in the SAA regime: The case for the internal market treatment of products, Beograd: Qendra për Politikë Evropiane, qershor 2023

8 Richard Grievson, A change of EU strategy in the Western Balkans is long overdue, Instituti i Vienës për Studime Ekonomike, shtator 2020.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet ta manifestojnë përkushtimin e tyre absolut në implementimin dhe monitorimin e implementimit të reformave lidhur me **acqui-në e Tregut të Vetëm. Interesi për t'u integruar në tregun e BE-së duhet të jetë i shoqëruar me dedikim politik dhe me implementimin e acqui-së përkatëse. Duhet të sigurohen fonde të mjaftueshme buxhetore të dedikuara për fuqizimin e kapaciteteve materiale dhe teknike, si dhe për mbajtje të personalit për t'ua mundësuar institucioneve kryesore që t'i mbrojnë rregullat dhe standardet evropiane. Nevojitet angazhimi proaktiv me odat tregtare për ndërtimin e kapaciteteve të sektorit privat me synimin për përmbushjen e kërkesave të legjislacionit ekzistues dhe të ardhshëm të Tregut të Vetëm të BE-së. Informacionet me kohë për sektorin privat lidhur me mundësitë dhe detyrimet nga qasja e aprovuar në Tregun e Vetëm të BE-së do t'ua mundësojë kompanive vendase, duke përfshirë NVM-të lokale, t'i bëjnë ballë detyrimeve për përputhshmëri.⁹**

Komisioni Evropian dhe liderët e Ballkanit Perëndimor duhet të sigurohen që dialogu politik për integrimin në BE të jetë i hapur dhe transparent për aktorët joshtetërorë. Bizneset mund ta ndajnë përvojën e tyre nga terreni për të identifikuar dhe trajtuar ngushticat kryesore në afat të gjatë si dhe të kontribuojnë për strategjitë për transformim afatgjatë. Duke mos e dëgjuar komunitetin afarist në rajon mund të zmadhohet presioni i tregut dhe të shkaktohet ndikim negativ mbi konkurrencën. Përfshirja e hershme e OSHQ-ve, që janë përkrahësit e zëshëm në procesin e aderimit në BE mund të ndihmojë për legjitimizimin e proceseve të reformave. Gjithashtu mund të jetë një investim në shoqërinë civile për të qenë partner i barabartë i politik-bërjes së BE-së në të ardhmen. Mbi të gjitha, një qasje e tillë gjithëpërfshirëse mund të ndihmojë për mobilizimin e të gjitha palëve të përfshira t'i monitorojnë raportet ekonomike e afariste dhe efektin e reformave të cilat janë ndërmarrë.

Përmirësim i bashkërenditjes së politikës së qeverisjes ekonomike

Qeverisja ekonomike dhe kornizat e bashkërenditjes për vendet anëtare mund të kombinohen me mekanizmat për aderim në BE për Ballkanin Perëndimor. Qasja në Tregun e Vetëm të BE-së nuk do ta përmirësojë menaxhimin me financat publike vetvetiu. Reformat strukturore sektoriale duhet të menaxhohen nëpërmjet ndryshimeve legislative, por në disa sfera të politikës, ato nuk janë kryesisht 'acquis'. Reformat në administratën publike, politikat arsimore, transformimi digjital dhe i blertë, si dhe hulumtimet dhe inovimet janë të nevojshme për një ekonomi që funksionon mirë dhe janë jashtëzakonisht të rëndësishme në aspekt të konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse.

Përpilimi i Programeve për Reforma Ekonomike (PRE) e ka krijuar strukturën institucionale dhe i ka mobilizuar shërbimet administrative për të punuar për një buxhet shumëvjeçar dhe për planifikim të reformave. Gjatë disa viteve të kaluara, niveli i implementimit të rekomandimeve specifike për secilin vend, në mesatare është më i lartë te vendet e BP6.¹⁰ Megjithatë, pa perspektivë të kapshme për zgjerim, ekziston rreziku që kjo të bëhet praktikë e imponuar. Mungon pronësi e fortë mbi procesin e PRE-ve në mesin e ministrive kompetente dhe masat e reformave strukturore kanë tendencën të jenë të përzgjedhura dhe të implementuara në bazë të fondeve buxhetore të dedikuara për sferat të cilat janë prioritet politik. Planifikimi shumëvjeçar buxhetor është joadekuat apo pro-formë; në të shumtën e rasteve, prioritizimi i masave strukturore nuk është transparent dhe nuk ka efekte transformuese.

Në aspekt të koordinimit ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së ekziston mospërputhje e dukshme ndërmjet ciklit vjetor për PRE dhe kalendarit semestral evropian. Administratat shtetërore në Ballkanin Perëndimor momentalisht u adaptohen afateve të ndryshme për planifikim, përgatitje dhe parashtrim. Për faktin që vendet kanë afate për parashtrim deri në janar, Strategjia vjetore për rritje të qëndrueshme nuk mund të merret parasysh dhe të inkorporohet në PRE-të. Ndërkaq, vendet anëtare dhe institucionet e BE-së nuk kanë forum, në të cilin ndërveprojnë dhe fitojnë mundësinë për t'i kuptuar më mirë sfidat teknike me të cilat përballen kandidatë në nivel operacional. Gjithashtu, vendet nuk kanë mundësi të shprehin mendimet e tyre lidhur me strategjinë e BE-së për rritje, megjithëse ky udhëzim politik drejtpërsëdrejti ose tërthorazi ndikon mbi ekonominë e tyre.

Në atë drejtim, Komisioni Evropian duhet të propozojë plan për harmonizim të Semestrit Evropian me ciklet e PRE-ve. Një koordinim më i afërt dhe i rregullt ex ante, në vend të koordinimit ex post, do të mundësojë detektim të hershëm, parandalim dhe korrigjim të çekuilibreve makroekonomike. Gjithashtu mund të jetë e dobishme në situatë të mbikëqyrjes dhe matjes së lehtë të performimit të vendeve në procesin e PRE. Një angazhim më thelbësor me institucionet e BE-së, madje edhe aplikimi i kushtëzimeve të Paktit për stabilitet dhe rritje dhe Procedurës për çekuilibër makroekonomik, mund të transferojë njohuri dhe të stimulojë planifikimin e buxheteve nacionale rreth reformave strukturore dhe financave të sigurta publike në afat të mesëm dhe afat të gjatë.

Komisioni Evropian duhet të mundësojë pjesëmarrje graduale të vendeve të Ballkanit Perëndimor në kornizën e BE-së për qeverisje ekonomike. Pjesëmarrja në Semestrin Evropian dhe kornizën më të gjerë të BE-së për qeverisje ekonomike mund të përhap më tepër entuziazëm ndërmjet zyrtarëve publikë, administratave si dhe aktorëve joshetërorë, duke e përforcuar të menduarit sistematik për reformat strukturore dhe rritjen e shkallës së zbatimit të tyre dhe të efektit të tyre.

10 Shih Progress towards Meeting the Economic Criteria for EU Accession The EU Commission's 2022 Assessments, dhe 2022 Economic Reform Programmes of Albania, Montenegro, North Macedonia, Serbia, Turkey, Bosnia and Herzegovina and Kosovo*: The Commission's Overview and Country Assessments

Përdorim më i mirë fondeve aktuale të BE-së dhe zmadhimi i tyre për Ballkanin Perëndimor

Qasja e BP6 në buxhetin e BE-së ka ngelur e kufizuar dhe shumë joproporcionale në raport me nivelin e integritimit të tregut të vet në BE. Përkrah disa ndryshimeve në shpërndarjet aktuale me Agjendën për Konektivitet dhe Planin ekonomik dhe investues, shpërndarjet totale të fondeve IPA për Ballkanin Perëndimor kanë ngelur të pandryshuara gjatë tre cikleve buxhetore të fundit në BE (2007-2013; 2014-2020; 2021-2027) duke përfshirë një periudhë prej 21 vit. Buxheti ka ngelur stabil në shumë prej përafërsisht 10 miliardë euro për secilën periudhë shtatëvjeçare. Të ardhurat mesatare për kokë banori në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë tërë periudhës 2021-2027 të KSHVF (MFF) është përlogaritur të kenë qenë në shumë prej 500 euro.¹¹

Në aspekt të diskutimeve mbi integritimin e lehtësuar të tregut, tema e zmadhimit të transfereve të BE-së për rajonin është duke fituar në rëndësi. Duke e pasur parasysh fokusin e ripërtëritjes mbi zgjerimin e BE-së nga fillimi i luftës së Rusisë në Ukrainë dhe në drejtim të metodologjisë së reviduar të zgjerimit “integritim i përshejtuar” dhe tiparin “phasing-in” mendimet lidhur me mënyrën se si Ballkanit Perëndimor t’i ofrohet qasje më e madhe në buxhetin e BE-së dhe pjesëmarrje në institucionet e BE-së janë duke fituar hov më të madh, siç është theksuar nga kryetarja e Komisionit në Forumin Globsek në Bratislavë dhe kryetari i EUCO në Forumin Bled gjatë verës së vitit 2023.

Krahas qëndrimit konsensual, se nevojiten investime të zmadhuara BE-së në rajon, diskutimet e grupit punues kanë theksuar sfida thelbësore siç janë nevojat e rritura për buxhetin e Bashkimit dhe kapaciteti absorbues në rajon. Sa i përket të parës, studimet kanë treguar që ndikimi financiar i mbështetjes së zmadhuar për Ballkanin Perëndimor do të ishte minimal mbi buxhetin e Bashkimit.¹² Ndërkaq, sa i përket të dytës, shumica e administratave të BP6 tanimë janë duke u përballur me vështirësi për të siguruar projekte përkatëse, rrjedhimisht nuk arrijnë t’i shfrytëzojnë fondet që i kanë në dispozicion, si dhe me përballen me çështje të praktikave të qeverisjes së dobët. Paralelisht me këtë, hulumtimet kanë treguar që fondet e BE-së, të cilat menaxhohen në mënyrë të decentralizuar nga administratat nacionale në rajon vazhdimisht janë zvogëluar.¹³ Kjo qasje e vë në pikëpyetje realizueshmërinë e kapacitetit ndërtues për vendet anëtare të ardhshme.

Deri kah fundi i vitit, Komisioni Evropian duhet të prezantojë një plan formal për stimulimin e ndihmës paraaderuese në këtë kornizë shumëvjeçare financiare (KSHVF) si pjesë e revidimit afatmesëm dhe të fillojë biseda me vendet anëtare të BE-së për ripërtëritjen e ndihmës paraaderuese në KSHVF-në e ardhshme, duke veçuar fonde për aderim eventual të vendeve, ndërsa të cilat do të aktivizohen në rast se plotësohen kushtet për aderim. Këto fonde duhet të jenë rreptësisht të lidhura me kushtëzimin e sundimit të së drejtës, siç është cekur në raportin e Gjykatës së revizorëve për shfrytëzimin e IPA fondeve për demokraci dhe sundimin e së drejtës.¹⁴

11 Reljic D, “The EU’s quest for strategic autonomy in the Western Balkans: Why it flopped,” in: *In Search of EU Strategic Autonomy: What Role for the Western Balkans? A Conversation with Odeta Barbullushi, Dejan Jović, Tanja Mišćević, Zoran Nechev, Dušan Reljić and Majda Ruge*, edited by Matteo Bonomi, Istituto Affari Internazionali, Rome, 2021, p. 37.

12 Vasja Rant, Mojmir Mrak & Matej Marinč (2020) The Western Balkans and the EU budget: the effects of enlargement, *Southeast European and Black Sea Studies*, 20:3.

13 Milena Mihajlovic, *Reforming the EU pre-accession instrument*, Beograd: Qendra për Politikë Evropiane, shtator 2023

14 Gjykata Evropiane e Revizorëve, 2022 “Special Report 01/2022: EU Support for the Rule of Law in the Western Balkans: Despite Efforts, Fundamental Problems Persist”

Gjithashtu, Komisioni Evropian duhet t'i revidojë modalitetet e realizimit të ndihmës për paraaderim në drejtim të lehtësimit të anëtarësimit të ardhshëm të Ballkanit Perëndimor në BE. Nga kjo perspektivë, këto modalitete të realizimit duhet të ndihmojnë për ndërtimin e kapaciteteve administrative, duke përfshirë, por jo vetëm, lehtësim të menaxhimit të decentralizuar të ndihmës.

Gjithashtu, Komisioni Evropian dhe qeveritë nacionale në Ballkanin Perëndimor duhet të sigurojnë gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje thelbësore të palëve kryesore të interesuara shoqërore, duke i përfshirë OSHQ-të, në planifikimin, vlerësimin e ndikimeve dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të BE-së. Objektivi do të ishte i dyfishtë: së pari, proceset e tilla do të lehtësojnë monitorimin në aspekt të kushtëzimit për sundim të së drejtës dhe së dyti, proceset e gjera do të sigurojnë konsensus mbi prioritetet, duke përfshirë fonde për përshtatjen e kompanive duke i përfshirë NVM-të, për qasje në Tregun e Vetëm dhe proceset e digjitalizimit dhe gjelbërimit.

Si parakusht, Komisioni Evropian dhe qeveritë nacionale të BP6 duhet që konsiderueshëm ta zmadhojnë transparencën e planifikimit, menaxhimit, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të fondeve paraaderuese. Transparenca është thelbësore për pjesëmarrje reale të aktorëve joshitetorë në proceset e përmendura më sipër, duke i informuar përfituesit e drejtpërdrejtë për ndihmën dhe përgjegjësinë e përgjithshme lidhur me shfrytëzimin e këtyre fondeve.